

## Përgjegjësia ndaj mjedisit

Përgjegjësia ndaj mjedisit është një nga çështjet horizontale të programit EJA Kosovë. Integrimi i ndërgjegjësimit dhe qëndrueshmërisë mjedisore në projekte është thelbësor për të siguruar që ndërhyrjet tuaja të kontribuojnë pozitivisht në mjedis dhe të mos shkaktojnë dëm. Ky udhëzues ofron një listë pyetjesh që të merren parasysh gjatë hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të intervenimeve tuaja.

**Analiza Mjedisore** është hapi i parë që duhet ndërmarrë për të ekzaminuar marrëdhënien midis intervenimit tuaj dhe mjedisit. Kjo përfshin identifikimin e kontributeve potenciale pozitive në qëndrueshmërinë mjedisore, ndikimet potenciale negative dhe cenueshmëritë klimatike. Qëllimi është të hartohen intervenime që maksimizojnë ndikimet pozitive dhe minimizojnë ose menaxhojnë në mënyrë efektive ndikimet negative.

Disa pyetje që duhet të merren parasysh gjatë hartimit dhe implementimit të programit/projektit janë:

- A mund të ketë programi/projekti ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë mjedisore? Cilat janë këto mundësi dhe si mund t'i përmirësojë programi/ projekti ato?
- A mund të ketë programi/ projekti ndonjë ndikim negativ në mjedis? Cilat janë këto ndikime potenciale dhe si mund të shmangen, reduktohen ose menaxhohen?
- A adresohen shqetësimet dhe mundësitë mjedisore në planet e menaxhimit për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programit/projektit?
- A ka organizata juaj kapacitete për menaxhimin mjedisor, duke përfshirë kapacitetin e stafit, politikat, udhëzimet dhe një sistem menaxhimi mjedisor? Si mund të përmirësohen këto kapacitete?

## Ndërgjegjësimi i Përgjithshëm Mjedisor

Për shumë OJQ, integrimi i përgjegjësisë mjedisore mund të jetë një koncept i ri. Në vijim janë disa pyetje shtesë për t'ju ndihmuar të mendoni se si puna juaj mund të ndërlidhet me çështjet mjedisore:

- Si i trajton aktualisht organizata juaj mbeturinat dhe riciklimin? A ka mënyra për të përmirësuar këto praktika që të jenë më miqësore për mjedisin?
- A promovon programi/projekti juaj përdorimin e materialeve dhe burimeve të qëndrueshme? Për shembull, a mund të përdorni materiale të ricikluara, të reduktoni përdorimin e letrës ose të integroni burime të rinovueshme të energjisë?
- Si mund të edukoni përfituesit dhe komunitetin tuaj për rëndësinë e përgjegjësisë ndaj mjedisit? A mund të përfshini aktivitete të ndërgjegjësimit mjedisor në programin/projektin tuaj?
- A ka mundësi bashkëpunimi me organizata mjedisore lokale ose ekspertë për të rritur ndikimin mjedisor të programit/projektit tuaj?
- Cilat janë metodat e transportit që përdoren për aktivitetet e programit/projektit? A mund të promovoni udhëtimet e përbashkëta, transportin publik ose alternativa të tjera miqësore për mjedisin për të reduktuar emetimet e karbonit?

Bashkëfinancuar nga: